


EGJISTRIMI I NEVOJAVE TË TË MOSHURËVE NË KOMUNËN E GOSTIVARIT

- RAPORT -



Ky projekt
financohet nga
Bashkimi Evropian



QENDRA
QYTETARE
E RESURSEVE



Botues:

Shoqata për ofrimin e shërbimeve sociale - SOCIO

Autor:

Katica Mihajlovic

Dizajn dhe printim:

FB Print&Design

Tirazh: 50

Ky publikim është përgatitur me ndihmë financiare nga Bashkimi Evropian në kuadër të projektit "Iniciativa lokale për përmirësimin e shërbimeve sociale për të moshuarit". Përmbajtja është përgjegjësi e projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian dhe të Qendrës së Resurseve Qytetare. "Iniciativa lokale për përmirësimin e shërbimeve sociale për të moshuarit" është projekt i zbatuar nga Shoqata për ofrimin e shërbimeve sociale "SOCIO", Gostivar në partneritet me Shoqatën Anisia nga Gostivari. Ky projekt është një subgrant i marrë në kuadër të "Mbështetjes së BE-së për Qendrën e Resurseve Qytetare – faza 2", e financuar nga Bashkimi Evropian.

PËRMBAJTJA

Hyrje	4
1. Kujdesi për të moshuarit në bashkësitë lokale	5
2. Shqyrtim të kornizës ligjore për mbrojtjen e të moshuarve	6
3. Metodologjia e regjistrimi të nevojave të të moshuarve në komunën e Gostivarit	7
4. Gjetjet kryesore nga intervistat me akterët lokal	8
5. Gjetjet nga anketa me të moshuarit	12
.....	17
Përfundime dhe rekomandime	21
Bibliografija	23
Shtojca:	23

Hyrje

Ky raport mbi regjistrimin e nevojave të të moshuarve në Komunën e Gostivarit përmban të dhëna për të moshuarit lidhur me gjendjen e tyre shëndetësore, familjare, banesore, materiale dhe nevojat e tyre për shërbime të caktuara. Raporti ofron një pasqyrë të burimeve ekzistuese në nivel lokal për të moshuarit dhe shqyrton mundësitë për zhvillimin e shërbimeve të reja bazuar në mundësitë dhe nevojat që ekzistojnë.

Përgatitja e këtij raporti është bërë në kuadër të projektit: "Iniciativa lokale për përmirësimin e shërbimeve sociale për të moshuarit". Projekti është një subgrant i marrë në kuadër të "Mbështetjes së BE-së për Qendrën e Resurseve Qytetare - Faza 2" e financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti realizohet nga Shoqata për ofrimin e shërbimeve sociale "SOCIO" dhe Shoqata për kulturë, sport dhe arsim "Anisija", të dyja këto shoqata janë aktive me veprimtarinë e tyre në Komunën e Gostivarit.

Qëllimi i projektit është të rrisë ndikimin e sektorit civil në krijimin e politikave lokale me synim zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve sociale për të moshuarit. Regjistrimi i nevojave të të moshuarve në Komunën e Gostivarit përfaqëson aktivitetin e parë të projektit, i cili u realizua gjatë muajve shkurt dhe mars të vitit 2025. Gjetjet nga ky regjistrim u prezantuan në një Forum me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave lokale, i mbajtur më 26 mars 2025, dhe në përputhje me diskutimet u plotësuan përfundimet dhe rekomandimet fillestare.

Plakja e popullsisë është një fenomen demografik global që i referohet rritjes së përqindjes së personave të moshuar në raport me popullsinë totale. Shkaqet e plakjes së popullsisë përbëjnë një kombinim kompleks faktorësh, përfshirë zhvillimin socio-demografik, përmirësimin e arsimit, përparimin e kushteve të punës, barazinë gjinore, avancimin e mjekësisë dhe të barnave.

Sipas rezultateve të Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2021 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, grupmosha nga 60 deri mbi 85 vjeç përfshin 419.125 persona në nivel shtetëror, që përfaqëson 22,8 përqind të popullsisë së përgjithshme. Kjo tregon se popullsia në vend po plakët, numri i personave të moshuar është në rritje, ashtu si edhe pjesëmarrja e tyre në totalin e popullsisë. Situatë e ngjashme vërehet edhe në Komunën e Gostivarit, ku nga 59.770 banorë rezidentë, 21,2% i përkasin grupmoshës nga 60 deri mbi 85 vjeç. Njëkohësisht, komuna e Gostivarit është një zonë që karakterizohet nga lëvizje të theksuara migratore, veçanërisht migrimet jashtë. Gjatë periudhës 2016-2020, janë regjistruar 5.500 qytetarë të cilët janë shpërngulur nga komuna me vendbanim të përhershëm jashtë vendit.

Ky trend në lidhje me popullsinë e moshuar sjell sfida të caktuara sociale, pasi ekziston një nevojë në rritje për mbështetje ndaj të moshuarve, të cilët për arsye të ndryshme konsiderohen si një kategori e cenueshme e popullsisë. Sipas përkufizimit të James Birren, një nga pionierët e gerontologjisë, plakja përfaqëson "një ndryshim i rregullt apo i zakonshëm i organizmave përfaqësues në një mjedis përfaqësues, që ndodh me kalimin e kohës."

Në dallim nga plakja, pleqëria përfaqëson periudhën e fundit të zhvillimit në jetën e njeriut dhe vlerësohet sipas moshës kronologjike (65+), rolit apo statusit shoqëror (dalja në pension) dhe statusit funksional (ulja e aftësive). Studiuesit dallojnë tre dimensione kryesore të pleqërisë: biologjike, psikologjike dhe shoqërore. Pleqëria biologjike përfshin ngadalësimin e funksioneve të organizmit, ajo psikologjike lidhet me ndryshimet në funksionet mendore dhe përshtatjen ndaj procesit të plakjes, ndërsa pleqëria shoqërore nënkupton ndryshimet në marrëdhëniet me bashkësinë dhe rolin në shoqëri.

Plakja aktive dhe e shëndetshme është një proces i plakjes së suksesshme dhe përfaqëson një koncept që përfshin perspektiva fiziologjike, psikologjike, shoqërore dhe personale. Njëkohësisht, është shumë e rëndësishme të theksohet se plakja e popullsisë përbën një sfidë për çdo shoqëri, duke pasur parasysh që personat e moshuar kanë nevojë të shtuara për mbrojtje dhe kujdes në aspekte të ndryshme të jetës.

Sipas OBSH-së (2002), plakja aktive mund të përkufizohet si “proces i optimizimit të mundësive për shëndet, pjesëmarrje dhe siguri me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës gjatë plakjes së njerëzve... (ajo) u mundëson individëve të realizojnë potencialin e tyre në aspektin fizik, shoqëror dhe mendor gjatë gjithë jetës dhe të marrin pjesë në jetën shoqërore, si dhe të kenë qasje në mbrojtje, siguri dhe kujdes të përshtatshëm kurdo që u nevojitet.” Në praktikë, kjo do të thotë se pas moshës 65-vjeçare, faktorët biologjikë nuk janë përcaktuesit kryesorë të mënyrës si plaket një individ, por ndikimin më të madh e kanë stili i jetesës, mjedisi dhe kultura në të cilat jetojmë.

1. Kujdesi për të moshuarit në bashkësitë lokale

Trendi i plakjes demografike të popullsisë në botë dhe ndikimi i tij në vendin tonë në vitet e fundit ka kontribuar në aktualizimin e pyetjes për kujdesin ndaj të moshuarve dhe pasojat që kjo shkakton në çështjet ekonomike dhe shoqërore të çdo vendi. Këto ndikime, kur shqyrtohen në nivel lokal, paraqesin një sfidë të veçantë për komunat që kanë një përqindje të lartë të popullsisë së moshuar. Prandaj, zgjidhjet duhet të fillojnë të kërkohen në nivel lokal, përmes përcaktimit të nevojave të të moshuarve dhe sigurimit të mbrojtjes në mjedisin ku ata jetojnë.

Përmirësimi sistematik, planifikimi dhe organizimi i mirëqenies sociale të qytetarëve në një bashkësi lokale është e mundur vetëm nëse adresohen nevojat e grupeve më të cënueshme të qytetarëve. Për këtë arsye, ndihma dhe mbështetja për këto grupe duhet të jenë pjesë e krijimit dhe zbatimit të politikave lokale, programeve dhe masave në fushën e mbrojtjes sociale. Ato duhet të bazohen në vlerësimin e kapaciteteve dhe resurseve të bashkësisë lokale, grupeve të identifikuara të cënueshme dhe nevojave të tyre, shërbimeve të disponueshme dhe zhvillimit të shërbimeve të përshtatshme në nivel lokal.

Kjo është në drejtim të decentralizimit në vendin tonë, kur pas vitit 2004, komunat morën mundësinë dhe përgjegjësinë për të zhvilluar funksionet sociale në nivel lokal, përkatësisht të krijojnë programe për grupe në rrezik social, duke përfshirë edhe të moshuarit. Me këtë, komunat mund të zhvillojnë forma jointitucionale të mbrojtjes përmes krijimit dhe organizimit të qendrave për kujdesin ditor dhe përkohëshëm të qytetarëve në varësi të nevojave të tyre, si dhe të organizojnë dhe zbatojnë mbrojtjen sociale për qytetarët e zonës së tyre përmes miratimit të programeve të zhvillimit të tyre në përputhje me nevojat specifike.

Ligji për mbrojtjen sociale (LMS) mbështet pushtetet lokale që të krijojnë institucione për mbrojtjen sociale të të moshuarve, siç është krijimi i Qendrave për qëndrim ditor dhe mbrojtje të përkohshme. Po ashtu, ligji lejon pushtetet lokale të delegojnë përgjegjësitë te subjekte të tjera ligjore dhe individë, përfshirë organizatat qytetare që janë aktive në fushën e mbrojtjes sociale. Organizatave qytetare të regjistruara në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (nga qershori 2024, e riemëruar në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë), iu mundësohet realizimi i aktiviteteve për mbrojtjen sociale, sipas kushteve dhe mënyrës të përcaktuara nga Ligji për mbrojtjen sociale.

Angazhimi i këtyre organizatave duhet të kontribuojë në zhvillimin e formave alternative jointucionale të mbrojtjes sociale, zhvillimin e mbrojtjes sociale për të moshuarit, përmirësimin e aksesit në shërbime, mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në nivel lokal.

2. Shqyrtim të kornizës ligjore për mbrojtjen e të moshuarve

Ligji për mbrojtjen sociale është akti kryesor ligjor që rregullon të drejtat dhe shërbimet në fushën e mbrojtjes sociale, përfshirë edhe të drejtat e të moshuarve. Për më tepër, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë miraton programe dhe rregullore që lidhen me mbrojtjen sociale të të moshuarve, duke përfshirë shërbimet për kujdesin në shtëpi, qëndrimin ditor dhe mbrojtjen institucionale.

Sipas Ligjit për mbrojtjen sociale, të moshuarit mund të përfitojnë të drejta nga mbrojtja sociale, edhe atë:

- Ndihmë të përhershme financiare, që mund të përfitojnë personat mbi 65 vjeç, të cilët janë të paafte për punë dhe nuk janë të siguruar materialisht dhe nuk mund të sigurojnë mbështetje nëpërmjet ndonjë forme tjetër.
- Ndihmë financiare për kujdes dhe ndihmë nga një tjetër person, mund të përfitojë personi që ka nevojë për kujdes dhe ndihmë nga një tjetër për të plotësuar nevojat themelore të jetesës.
- Ndihmë financiare njëherë dhe ndihmë në natyrë, që ofrohet për ata që janë në një gjendje rreziku social. Kjo kategori përfshin edhe të moshuarit.
- Ndihmë financiare për strehim social, e siguruar për përdoruesit e ndihmës financiare të përhershme, nga buxheti i komunave, apo nga burime të tjera si donacione, fonde, kredi dhe të tjera.
- Mbrojtja shëndetësore, përfitojnë përdoruesit e ndihmës financiare të përhershme, të moshuarit të cilët janë të strehuar në institucione, në familje kujdesi dhe përdoruesit e ndihmës financiare për kujdes dhe ndihmë nga një tjetër person, nëse ata nuk e përfitojnë këtë shërbim në një bazë tjetër.

Të moshuarit, sipas Ligjit, mund të përfitojnë gjithashtu të drejta për mbrojtje jointucionale, dhe atë:

- Shërbimi i parë social, ndihmë për individin dhe ndihmë për familjen, janë shërbime që adresojnë problemin që buron nga një gjendje rreziku social, ku ofrohet këshillim ose punë këshillimore për të moshuarit dhe familjen nga qendra për punë sociale, me qëllim që të kapërcehet rreziku në të cilin janë ndodhur.
- Kujdes në shtëpi dhe ndihmë për individin dhe familjen, mund të përfitohet nga të moshuarit dhe personat e dobësuar, të cilëve u nevojitet kujdes dhe ndihmë për të plotësuar nevojat themelore të jetesës.
- Kujdesi ditor, sigurohet në formën e qëndrimit ditor, ushqimit, mbajtjes së higjienës personale, organizimit të aktiviteteve kulturore dhe argëtuese dhe aktiviteteve punuese.
- Pranim dhe kujdes i përkohshëm, sigurohet për të moshuarit viktime të çdo lloji dhune.

Të moshuarit kanë të drejtën për të u strehuar në një institucion publik për të moshuarit, si dhe të drejtë për mbrojtje institucionale, në katër institucionet publike për strehim të të moshuarve në vend, si dhe në institucione private për mbrojtjen sociale të të moshuarve.

Në Ligjin për Familje (Gazeta Zyrtare nr. 84/2008) janë rregulluar detyrimet e fëmijëve për mbështetje financiare të prindërve të paaftë financiarisht. Kjo detyrë merret parasysh edhe në rastin e jetesës së vetme dhe kur të moshuarit vendosin të strehohen në institucion, nëse ata janë të aftë financiarisht.

Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor (Gazeta Zyrtare nr. 98/2012, nr. 166/12, nr. 15/13) rregullon të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor, të cilat janë të rëndësishme për sigurinë ekonomike dhe sociale të të moshuarve. Ky ligj përcakton të drejtën për pensionin e pleqërisë, që është i kushtëzuar nga arritja e moshës së caktuar, më pas të drejtën për pensionin e invaliditetit, që merret me shfaqjen e invaliditetit; të drejtën për pensionin familjar dhe të drejtën për shumën më të ulët të pensionit.

Ligji për sigurimin social të të moshuarve (Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 104/19) parashikon që personat që nuk përfitojnë pension dhe që janë materialisht të pasiguruar, dhe që kanë mbushur moshën 65 vjeç, mund të fitojnë të drejtën për ndihmë financiare, e cila quhet "sigurim social për të moshuarit" ose "pension social".

Strategjia Kombëtare për të Moshuarit (2010-2020) përcakton objektivat dhe masat strategjike për përmirësimin e cilësisë së jetesës së të moshuarve në vend. Ky dokument shqyrton aspekte të ndryshme të të drejtave dhe shërbimeve për të moshuarit, duke u fokusuar në përfshirjen e tyre në sistemin e mbrojtjes shëndetësore dhe sociale.

3. Metodologjia e regjistrimi të nevojave të të moshuarve në komunën e Gostivarit

Procesi i regjistrimi filloi me një shqyrtim të detajuar të dokumenteve në nivel nacional dhe lokal në fushën e mbrojtjes sociale të të moshuarve. Kjo fazë ofroi informacion mbi politikat, programet dhe shërbimet aktuale, si dhe mbi analizat ekzistuese për këtë grup synues. Të dhënat e mbledhura shërbyen si bazë për zhvillimin e një pyetësoi të saktë dhe relevant për të moshuarit dhe një pyetësoi për intervistë me akterët lokalë.

Pyetësoi për të moshuarit ishte i strukturuar për të siguruar të dhëna mbi aspekte të ndryshme të jetës dhe nevojave të tyre. Ato përfshinin: Strukturën demografike, të dhëna për moshën, gjininë, gjendjen martesore, dhe vendbanimin; Gjendja shëndetësore dhe kujdesi, nevoja për shërbime mjekësore. Më pas, Gjendja familjare dhe interaksionet, marrëdhënia me familjen dhe niveli i mbështetjes; Kushtet materiale dhe të jetesës, cilësia e banesës, burimet financiare; Shërbimet për mbështetje dhe ndihmë, përdorimi dhe nevoja për shërbime sociale. Të gjitha këto aspekte paraqesin tregues të rëndësishëm për përcaktimin e cilësisë së jetesës së të moshuarve.

Pyetësoi për përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave ishte gjysmë i strukturuar, me një kombinim të pyetjeve të mbyllura dhe të hapura. Në këtë mënyrë u përfshinë aspekte konkrete të shërbimeve dhe u siguruan të dhëna kualitative për shërbimet dhe mbështetjen për të moshuarit, përfshirjen sociale dhe aktivitetet, hapësirën dhe infrastrukturën për kujdesin.

Procesi i regjistrimit përfshiu një anketë direkte me gjithsej 102 të moshuar nga komuna e Gostivarit, duke përfshirë si mjedise urbane ashtu edhe rurale. Anketa përfshinte përdorues të pensioneve të pleqërisë, pensioneve invalidor, pensioneve familjare, përdorues të shërbimit të kujdesit nga një tjetër person, shërbimit të kujdesit dhe ndihmës në shtëpi, si dhe shërbimeve të tjera sociale.

Për më tepër, u realizuan intervista me përfaqësues të autoriteteve lokale, shërbimit social dhe shëndetësor, ofrues të shërbimeve sociale, organizata qytetare, shoqata të pensionistëve, si dhe përfaqësues të këshillit socio-ekonomik lokal.

Kombinimi i metodave kornizore (anketa) dhe kualitative (intervista) siguroi një pamje të plotë dhe të thelluar të gjendjes së të moshuarve në komunë. Pjesëmarrja e grupeve dhe akterëve të ndryshëm siguroi përfaqësueshmëri dhe relevancë për procesin e regjistrimit.

4. Gjetjet kryesore nga intervistat me akterët lokal

Për qëllimet e regjistrimit, u realizuan intervista me përfaqësues të autoriteteve lokale, ofrues të shërbimeve sociale dhe shëndetësore, ofrues të shërbimeve sociale, organizata qytetare dhe shoqata pensionistësh nga komuna e Gostivarit.

Intervistat u realizuan me institucionet dhe organizatat në vijim, si dhe me përfaqësuesit e tyre:

- Institucioni Publik Qendra për Punë Sociale në Gostivar;
- Njësia për Zhvillim Ekonomik Lokal, Integritet Evropian dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në Komunën e Gostivarit;
- Institucioni Shëndetësor Privat "Dr. Veljanoski";
- Institucioni Shëndetësor Privat "Dr. Branislav";
- Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Organizata Komunale Gostivar;
- Qendra e Resurseve të Prindërve të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta;
- Asociacioni i organizuar i të Rinjve;
- Shoqata për ofrimin e shërbimeve sociale „SOCIO“;
- Shoqata e Pensionistëve të Komunës së Gostivarit;
- Shoqata e Personave me Aftësi të Kufizuara nga Puna;
- Këshilli Lokal Socio-Ekonomik.

Nga Qendra për Punë Sociale në Gostivar theksojnë se Qendrat për Punë Sociale në nivel lokal realizojnë shërbimet e mbrojtjes sociale për personat e moshuar, duke përfshirë vlerësimin e nevojave, ofrimin e shërbimeve dhe ndjekjen e efikasitetit të tyre.

Në të njëjtën kohë, ata theksuan se legjislacioni aktual inkurajon bashkëpunimin ndër-sektorial për ofrimin e mbrojtjes për personat e moshuar. Sipas Ligjit për Mbrojtjen Sociale, aktivitetet parandaluese realizohen nga Qendrat për Punë Sociale në bashkëpunim me autoritetet lokale, institucionet shëndetësore lokale dhe institucione të tjera publike, si dhe me organizata qytetare. Qendra disponon me staf profesionist, punonjës social dhe psikologë, të cilët sigurojnë punën profesionale dhe këshillimore. Aktualisht, 120 persona të moshuar përfitojnë shërbimin e ndihmës dhe kujdesit në shtëpi, i cili ofrohet në bashkëpunim me organizata lokale qytetare.

Mbrojtja sociale është njohur dhe e pranuar si një kompetencë e rëndësishme nga ana e vetëqeverisjes lokale të Gostivarit, e cila është zhvilluar më intensitet në vitet e fundit. Komuna ndjek drejtimet strategjike në këtë fushë dhe trendet e zhvillimit të lidhura me pluralizimin dhe decentralizimin në ofrimin e mbrojtjes sociale për popullatën lokale. Në këtë drejtim, në vitin 2020, Komuna e Gostivarit u përfshi si një komunë pilot në një projekt që u realizua në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Zyrën e UNDP në Shkup. Qëllimi i projektit ishte realizimi i aktiviteteve për mbështetje të zhvillimit të veprimtarisë së mbrojtjes sociale në komunë. Pilot projekti u përqendrua në ofrimin e ndihmës

profesionale dhe mbështetje për krijimin e Këshillit Komunal për Mbrojtje Sociale, si dhe përgatitjen e Planit Social për rajonin e komunës së Gostivarit, i miratuar në vitin 2020.

Komuna ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Asociacionin e organizuar e të rinjve për ofrimin e shërbimit social të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi për personat e moshuar.

Përfaqësuesit e shërbimit shëndetësor primar në intervistat theksuan se me plakjen, funksionet trupore dobësohen, problemet shëndetësore dhe sëmundjet kronike bëhen gjithnjë e më të shpeshta, dhe sidomos pas moshës shtatëdhjetë vjeçare shfaqen ndryshime të rëndësishme që kufizojnë lëvizshmërinë dhe ndryshojnë nevojat.

Si sëmundjet dhe gjendjet kronike më të shpeshta te personat e moshuar, ata i theksuan këto: tension i lartë i gjakut, kolesterol i lartë, artriti, dobësi ishemike e zemrës, diabeti, pamjaftueshmëri kronike e veshkave, si dhe depresioni, sëmundja e Alzheimerit dhe dementa, por edhe sëmundja kronike obstruktive e mushkërive. Përveç diagnozës kryesore, personat e moshuar shpesh kanë edhe sëmundje shtesë.

Më tej, përfaqësuesit e shërbimit shëndetësor primar theksojnë nevojën për t'u dhënë më shumë kompetenca mjekëve amë, me qëllim që të zvogëlohet ngarkesa mbi shërbimet shëndetësore sekondare dhe terciare, gjë që do të jetë në dobi edhe të vetë pacientëve. Kontrollet mjekësore të rregullta, edukimi i duhur me theks te parandalimi i komplikimeve nga sëmundja kryesore dhe komorbiditetet e shumta, kujdesi i përshtatshëm në shtëpi dhe lehtësimi i qasjes në institucione janë ndër aspektet kyçe që duhet të përmirësohen.

Nga nevojat specifike të personave të moshuar, ofruesit e kujdesit shëndetësor e vërejnë problemin me numrin e madh të barnave të përshkruara që ata duhet të përdorin, por edhe refuzimin për t'i marrë terapitë e përshkruara, gjë që çon në grumbullim të barnave dhe shkakton kosto të mëdha për sistemin shëndetësor.

Veçanërisht theksohet rezistenca e personave të moshuar ndaj ndryshimit të zakoneve të jetesës, të cilat kanë të bëjnë me ushtrime fizike, përshtatjen e kushteve në shtëpi (si vendosja e mbajtëseve), si dhe blerjen e këpucëve të përshtatshme për të shmangur rrezikun nga rrëzimet brenda në shtëpi.

Për një bashkëpunim të suksesshëm në procesin e kujdesit për personat e moshuar, të anketuarit theksojnë rëndësinë e bashkëpunimit të mirë dhe shkëmbimit të të dhënave dhe informacioneve ndërmjet mjekëve, shërbimit patronazhi dhe mbrojtjes sociale.

Në territorin e Komunës së Gostivarit janë të regjistruara katër organizata që ofrojnë shërbimin social të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi. Këto janë organizatat në vijim: Kryqi i Kuq, Qendra e Resurseve e Prindërve të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta, Asociacioni i Organizuar i të Rinjve dhe Shoqata për Ofrimin e Shërbimeve Sociale "SOCIO".

Këto organizata janë ofrues të licencuar të shërbimeve sociale, përkatësisht kanë leje për ushtrim veprimtarie në fushën e mbrojtjes sociale për ofrimin e shërbimit – ndihmë dhe kujdes në shtëpi, të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale. Për të marrë këtë leje, secila organizatë ka kaluar

nëpër një proces licencimi duke përmbushur kriteret dhe standardet për ofrimin e shërbimit të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi për personat e moshuar. Këto standarde kanë të bëjnë me sigurimin e hapësirës së nevojshme, mjeteve dhe stafit të përcaktuar sipas nivelit të kualifikimeve dhe profileve, numrit të përdoruesve dhe dokumentacionit të domosdoshëm për organizimin e shërbimit.

Të gjitha organizatat kanë siguruar hapësirë zyre dhe posedojnë pajisjet e nevojshme për punë, siç janë tavolina, karrige, kompjuter dhe printer. Njëkohësisht, ato disponojnë edhe me pajisje të përshtatshme për kujdestarët, si çanta shpine, aparate për matjen e tensionit të gjakut, sheqerit në gjak, termometra etj.

Përfitues të shërbimit të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi janë persona me kapacitet të reduktuar, të reduktuar në mënyrë të konsiderueshme ose plotësisht të munguar funksional, të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen vetë për veten dhe jetojnë në shtëpinë e tyre. Me këtë shërbim sigurohet ndihmë për realizimin e aktiviteteve bazë dhe instrumentale të jetës së përditshme të përfituesit, në maksimum deri në 80 orë në muaj.

Aktivitetet bazë të jetës së përditshme janë: mbajtja e higjienës personale, veshja, lëvizshmëria brenda në shtëpi, ushqyerja, përdorimi i tualetit dhe ndërrimi i pelenave dhe mbrojtëseve në rast të inkontinencës.

Aktivitetet instrumentale të jetës së përditshme përfshijnë: mbështetje për pastrim, ndërmjetësim për riparime, larje rrobash, gatim, blerje produktesh, lëvizje jashtë shtëpisë, marrje e terapisë mjekësore, përdorim të telefonit dhe ndihmë në menaxhimin e buxhetit. Të gjitha këto aktivitete janë të orientuara drejt ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së përdoruesve.

Të gjitha organizatat kanë të caktuar një koordinator/e përgjegjës për drejtimin e drejtpërdrejtë, vlerësimin e nevojave të përdoruesve dhe koordinimin e punës. Ndërsa aktivitetet për përdoruesit i realizojnë kujdestarë/kujdestare – të cilët kanë përfunduar trajnim sipas një programi të akredituar për ofrimin e shërbimeve dhe ndihmës në shtëpi – si dhe infermierë.

Qendra e Resurseve e Prindërve të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta disponon me 12 kujdestarë të certifikuar dhe 37 përdorues të shërbimit të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi. Nga Qendra theksojnë se ka një nevojë reale për zgjerimin e licencës dhe kontratave administrative për kujdestarë të rinj, me qëllim që të përfshihen më shumë persona të moshuar dhe të mund të përfitojnë nga shërbimi i ndihmës dhe kujdesit në shtëpi. Po ashtu, Qendra është në proces të hapjes së një Qendre Ditore për persona të moshuar me plakje aktive.

Asociacioni i Organizuar i të Rinjve është gjithashtu një ofrues i licencuar i shërbimit të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi. Shoqata ka 20 kujdestarë të certifikuar dhe aktualisht ka 26 përdorues. Nga Asociacioni theksojnë se ka një interes të madh dhe kërkesë për shërbimin e ndihmës dhe kujdesit në shtëpi.

Shoqata për Ofrimin e Shërbimeve Sociale "SOCIO" në Gostivar shërben 43 përdorues me ndihmën e 19 kujdestarëve. Shumica e përdoruesve të SOCIO përkasin në grupmoshën 76 deri 85 vjeç. Sa i përket strukturës gjinore, gratë janë më të përfaqësuara si përdoruese të shërbimeve. Pjesa më e madhe e përdoruesve përdorin shërbimin për 40 orë në muaj.

Vlerësimi i rregullt (evaluimi) i shërbimeve që realizohen nga ofruesit e shërbimeve sociale tregon se për shumë persona të moshuar, vizitat e kujdestareve nuk përbëjnë vetëm ndihmë shëndetësore, por edhe një kontakt të rëndësishëm shoqëror. Këto vizita përmirësojnë ndjeshëm shëndetin psikologjik dhe emocional të përdoruesve. Për të moshuarit, këto interaksione janë një pjesë e rëndësishme e ditës së tyre dhe kontribuojnë në përmirësimin e mirëqenies së tyre të përgjithshme.

Organizata e Kryqit të Kuq në Gostivar u themelua në vitin 1950 dhe ka përvojë disa dekadash në realizimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve në fushën e mbrojtjes sociale. Në kuadër të Kryqit të Kuq të Gostivarit është realizuar një projekt për shërbim, përkatësisht kryerjen e vizitave të personave të moshuar në kushte shtëpiake. Kryqi i Kuq ofron shërbime të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të ndihmës humanitare dhe mbështetjes për personat e moshuar, të dobët, të sëmurë, për persona me aftësi të kufizuara, familje të prekur nga fatkeqësi dhe katastrofa natyrore, si dhe për grupe të tjera shoqërisht të cenueshme. Çdo vit shënohet Java e Personave të Moshuar.

Ofruesit e shërbimeve sociale dhe shëndetësore, bazuar në përvojën e tyre nga puna me personat e moshuar, përmendin problemet më të rëndësishme, të tilla si mungesa e kujdesit nga bashkësia, mungesa dhe rëndësia e parandalimit primar, rëndësia e ruajtjes së pavarësisë, rëndësia e komunikimit dhe mbështetja emocionale.

„... Duhet t'u ofrohet mbështetje emocionale dhe të tregohen atyre se ata janë të rëndësishëm...“
„... më e rëndësishmja është komunikimi, biseda me personat e moshuar...“
„... Personat e moshuar nuk duhet të stigmatizohen dhe të mbyllen në shtëpitë e tyre...“

Shoqata e Pensionistëve të Komunës së Gostivarit është anëtare e Unionit të Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë, si një organizatë e pavarur, joqeveritare dhe jo politike. Shoqata vepron në kuadër të akteve të saj normativë (Statuti, Rregullorja e Punës, programi dhe të tjera) si një person juridik. Aktivitetet dhe veprimtaritë e Shoqatës realizohen përmes fondeve financiare që mblidhen kryesisht nga anëtarësimi. Për realizimin e punëve profesionale dhe administrative, ajo ka formuar komisionet e saj profesionale.

Shoqata e Pensionistëve, për fat të keq, nuk disponon me një hapësirë ku personat e moshuar do të kishin mundësinë për t'u takuar, luajtur, marrë pjesë në lojëra interaktive, organizuar tribuna dhe ligjërata edukative, dhe ata apelojnë që sa më shpejt të sigurohen kushte hapësinore për aktivitetet e tyre.


Përfaqësuesit e Këshillit Lokal Ekonomik-Social (KLES) në Komunën e Gostivarit mendojnë se numri i personave të moshuar, të cilët edhe pas pensionimit ende ndihen të aftë për të kryer aktivitete profesionale dhe kanë nevojë të mbeten aktivë, është në rritje. Për këtë popullatë, është e nevojshme të organizohen kurse profesionale mbi tema të ndryshme (kopshtari, kultivimi i luleve, bletari, thurje, qepje dhe të tjera). Kjo do t'i ndihmojë ata të ndihen të angazhuar dhe të plotësuar, duke kryer aktivitete që gjatë jetës profesionale mund të kenë pasur dëshirë t'i kryenin, por nuk kanë pasur kohë t'i realizonin.

5. Gjetjet nga anketa me të moshuarit

Struktura demografike e të anketuarve


Anketa ka përfshirë gjithsej 102 të anketuar. Të anketuarit u ndanë në gjashtë grup moshash: 60 - 64 vjeç; 65 - 69, 70 - 74, 75 - 79, 80 - 84 dhe mbi 85 vjeç. Shumica e të anketuarve, 27%, i përkasin kategorisë së moshës 65 - 69 vjeç, e ndjekur nga 23% e të anketuarve të grup moshës 70 - 74 vjeç. Të anketuarit e moshës 60-64 vjeç dhe të anketuarit e moshës 80-84 vjeç përfaqësohen me 16% secili, grupmosha 75-79 vjeç përfaqësohet me 12%, dhe personat mbi 85 vjeç përfaqësohen me 6%. Me rritjen e moshës së popullsisë së hulumtuar, pjesëmarrja e tyre në mostrën e hulumtimit zvogëlohet.

Në përmbledhje, gjysma e të anketuarve (50%) janë midis moshës 65 dhe 74 vjeç.



Grafiku 1: Moshë e të anketuarve

Duke parë gjininë e të anketuarve, pjesëmarrja e gjinisë femrore është më e lartë. 56 nga të anketuarat i përkasin gjinisë femërore, përkatësisht 55%, ndërsa 46 të anketuar, përkatësisht (45%) i përkasin gjinisë meshkullore.



Grafiku 2: Struktura gjinore

Sipas përkatësisë etnike, 53% e të anketuarve janë maqedonas, 36% janë shqiptarë, 10% turq dhe 1% romë. Tek të anketuarit maqedonas dhe turq, përqindja e gjinisë femërore është më e lartë (55%), ndërsa tek shqiptarët të dy gjinitë janë të përfaqësuara në mënyrë të barabartë.

Struktura etnike dhe gjinore							
Maqedonas/e		Shqiptar/e		Turk/e		Rom/e	
M	F	M	F	M	F	M	F
25	29	18	18	5	6	0	1


Tabela 1: Struktura etnike dhe gjinore

Kur bëhet fjalë për gjendjen martesore, pjesa më e madhe e të anketuarve (63.5%) jetojnë në bashkësi martesore, megjithatë një përqindje e konsiderueshme janë të ve/vejushe (33.7%). Një përqindje më e vogël e të anketuarve janë të pamartuar (1.9%) dhe të divorcuar (1%).

Gjendja martesore	Përqindje
I martuar/e martuar	63.5%
I pa martuar/E pa martuar	1.9%
I divorcuar/e divorcuar	1%
I ve/vejushe	33.7%

Tabela 2: Gjendja martesore

Pjesa më e madhe e të anketuarve (83%) jetojnë në qytet. Ndërsa 17% e tyre jetojnë në vendbanime përreth dhe fshatra që gravitojnë drejt Komunës së Gostivarit: Pitarnica, Fazaneria, Cigllana dhe Balindoll.



Grafiku 3: Vendbanimi

Gjendja shëndetësore, nevojat mjekësore dhe kujdesi

Grupi i parë i pyetjeve kishte të bënte me gjendjen shëndetësore, nevojën për mbrojtje shëndetësore dhe kujdesin për personat e moshuar.


Të anketuarit u pyetën të japin një vlerësim për gjendjen e tyre shëndetësore. **47 të anketuar** e vlerësuan gjendjen e tyre si **të mirë**, ndërsa **32 si të kënaqshme**. Vlen të theksohet se, për këtë pyetje, shumë prej të anketuarve shtuan edhe komentin **“e mirë për moshën”**, duke treguar se gjendjen shëndetësore e vlerësojnë në përputhje me moshën dhe janë të vetëdijshëm për rënien e funksionalitetit me plakjen. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve e vlerësojnë shëndetin e tyre si **të keq (16 persona)** dhe **shumë të keq (3 persona)**.

Sa i përket përgjigjeve për gjendjen shëndetësore sipas strukturës gjinore, nuk ka ndonjë dallim të theksuar midis burrave dhe grave në vlerësimin e gjendjes së tyre shëndetësore si të kënaqshme. Më shumë bie në sy vlerësimi "i mirë", ku më shumë gra e konsiderojnë gjendjen e tyre shëndetësore si të mirë, por gjithashtu edhe më shumë gra e vlerësojnë gjendjen e tyre si të keqe.

Gjendja shëndetësore									
Shkëlqyeshme		E mire		E kënaqshme		E keqe		Shumë e keqe	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
3	1	20	27	17	15	5	11	1	2


Tabela 3: Gjendja shëndetësore

Në pyetjen "Sa shpesh keni nevojë të vizitoni mjekun?", të anketuarit përgjigjën si vijon: më së shumti vizitojnë mjekun një herë në muaj (41%) që lidhet me nevojën e tyre për një furnizim të rregullt dhe në kohë me medikamentet e nevojshme. Disa herë në vit vizitojnë mjekun 39% e të anketuarve, ndërsa 14% thanë se shkojnë te mjeku një herë në javë. Vetëm 1% thanë se shkojnë çdo ditë, ndërsa 5% e të anketuarve thanë se nuk kanë nevojë për vizita te mjeku.



Grafiku 4: Nevoja për mjek


Anëtarët e familjes së ngushtë ende e kanë rolin dominues në ofrimin e ndihmës së nevojshme në rast sëmundjeje të personit të moshuar. Të dhënat tregojnë se zakonisht bashkëshorti apo bashkëshortja është ai/ajo që ofron ndihmën dhe kujdesin e nevojshëm (45 të anketuar), por gjithashtu ndihmë dhe kujdes ofrojnë edhe fëmijët e tyre (44 të anketuar). Për një pjesë të të anketuarve (8), kujdesin gjatë sëmundjes e marrin përsipër të afërmit dhe fqinjët/shokët (2). Vetëm 3 të anketuar kanë përgjigjur se askush nuk kujdeset për ta kur janë të sëmurë.



Grafiku 5: Kujdesi për të anketuarit


Statusi familjar dhe marrëdhëniet/ndërveprimet

Në lidhje me pyetjen nëse jetojnë vetëm apo me familjen, të anketuarit janë përgjigjur si më poshtë: 18 prej tyre janë përgjigjur se jetojnë vetëm, ndërsa shumica kanë thënë se jetojnë me partnerin e tyre martesor – plot 52 persona. Përgjigjet e tjera janë si vijon: me fëmijët e tyre jetojnë 29 të anketuar, ndërsa me të afërmit e tyre (familjarë) jetojnë vetëm 3 nga të anketuarit.



Grafiku 6: Mënyra e jetesës


Interesant është informacioni i marrë nga pyetja e radhës, sa shpesh kanë kontakte/vizita nga familja dhe miqtë. 21% e të anketuarve kanë kontakte çdo ditë, ndërsa 32% kanë kontakte një herë deri dy herë në javë. Madje 34% e të anketuarve kanë kontakte disa herë në muaj dhe ajo që shqetëson është se një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (13%) kanë kontakte disa herë në vit. Kjo është një tregues i përjashtimit social të një pjese të personave të moshuar.



Grafiku 7: Shpeshtësia e kontakteve

Gjendja materiale dhe e vendbanimit

Pyetjet në vijim kanë të bëjnë me kushtet banesore dhe materiale të të moshuarve, të cilat janë tregues të rëndësishëm për sigurinë e tyre. Pothuajse të gjithë të anketuarit janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen lidhur me kushtet e vendbanimit të tyre. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 19 janë përgjigjur se kanë kushte shumë të mira për jetesë, ndërsa shumica – 60 të anketuar – kanë deklaruar se kushtet e tyre për jetesë janë të mira. Gjendjen banesore 19 të anketuar e kanë vlerësuar si të kënaqshme, ndërsa 4 janë përgjigjur se kushtet e tyre për jetesë janë të këqija.



Grafiku 8: Kushtet e jetesës në vendbanimin tuaj

Përveç kësaj, të anketuarit u pyetën nëse kishin nevojë për përmirësime ose përshtatje në vendbanimin e tyre. Përgjigjet kishin të bëjnë me ndërhyrje të tilla si ndërrimi i dritareve, rregullimi i tualeteve me kabina dushi, përmirësimi i qasjes, si dhe ndryshimi i mënyrës së ngrohjes nga druri në energji elektrike.

Shumica e të anketuarve 51 persona (25 burra dhe 26 gra) përgjigjën se të ardhurat e tyre pjesërisht i plotësojnë nevojat, 39 të anketuar (15 burra dhe 24 gra) janë të kënaqur me të ardhurat, ndërsa 12 të anketuar (6 burra dhe 6 gra) përgjigjën se të ardhurat nuk i plotësojnë nevojat e tyre.

A i plotësojnë të ardhurat nevojat?					
Po		Jo		Pjesërisht	
M	F	M	F	M	F
15	24	6	6	25	26

Tabela 4: Të ardhurat

Sipas përkatësisë etnike, ka disa dallime në përgjigjet lidhur me atë nëse të ardhurat mujore plotësojnë nevojat e të anketuarve. 46% e maqedonasve u përgjigjën se me të ardhurat e tyre plotësohen pjesërisht nevojat, ndërsa 56% e shqiptarëve kishin të njëjtën përgjigje. 43% e maqedonasve janë të kënaqur me të ardhurat e tyre, krahasuar me 31% të shqiptarëve që janë të kënaqur me të ardhurat mujore. Tek të


anketuarit nga komuniteti turk, përgjigjet janë të barabarta, pasi përqindja e atyre që janë të kënaqur dhe atyre që janë pjesërisht të kënaqur me të ardhurat është e njëjtë.

Të ardhurat											
Maqedon/e			Shqiptar/e			Turk/e			Rom/e		
PO	JO	Pjesë.	PO	JO	Pjesë.	PO	JO	Pjesë.	PO	JO	Pjesë.
23	6	25	11	5	20	5	1	5	1	0	0

Tabela 5: Të ardhurat sipas përkatësisë etnike

Shërbime mbështetjeje dhe ndihme


Përgjigjet janë të ndryshme në lidhje me atë se çfarë lloj mbështetjeje ose ndihme u nevojitet të moshuarve. Më së shumti prej tyre (37) janë përgjigjur se kanë nevojë për shoqërim me bashkëmoshatarë, pastaj 23 kanë thënë se kanë nevojë për blerje barnash, ushqimesh dhe pagesa të faturave, ndërsa 15 kanë thënë se kanë nevojë për transport si lloj mbështetjeje. 14 të anketuar kanë nevojë për ndihmë në mirëmbajtjen e higjienës personale dhe 12 të anketuar kanë thënë se kanë nevojë për organizimin e kohës së lirë – organizimin e aktiviteteve kulturore dhe argëtuese.



Grafiku 9: Lloji i mbështetjes

Nga përgjigjet në pyetjen se cilat shërbime u nevojiten të moshuarve në bashkësinë tuaj, mund të shihet se përqindja më e madhe e të anketuarve, 70%, mendojnë se të moshuarit kanë nevojë për ndihmë dhe kujdes në shtëpi. 16% e të anketuarve mendojnë se do të ishte mirë të përdoren shërbime në Shtëpinë për të Moshuar, ndërsa 14% mendojnë se do të ishte e dobishme që të moshuarit të përdorin shërbime në Qendër Ditore për të Moshuar.


Sipas mendimit tuaj, cilat shërbime do të ishin të dobishme për të moshuarit në bashkësinë tuaj?



Grafiku 10: Shërbime për personat e moshuar

Nga grafiku i mëposhtëm mund të nxirren përfundime se të anketuarit janë më së shumti të interesuar për të përdorur shërbime të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi – 75%. Rreth 15% e të anketuarve janë të interesuar për shërbime në Qendrën Ditore për të Moshuar, ndërsa vetëm 10% do të përdornin shërbime në Shtëpinë për të Moshuar.


Cilën nga këto shërbime do të ishit të interesuar ju të përdorni?



Grafiku 11: Shfrytëzimi i shërbimeve

Të dhënat në grafik për besimin në subjektet për organizimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale për të moshuarit tregojnë shumëllojshmëri. Të gjitha përgjigjet e ofruara janë në interes të të anketuarve dhe janë si më poshtë: 39% e të anketuarve kanë thënë se ndihma dhe kujdesi për të moshuarit duhet të organizohet nga një Institucion Publik për Mbrojtje Sociale, 33% mendojnë se kjo duhet të bëhet nga një

organizatë qytetare, 10% e konsiderojnë se kjo duhet të bëhet nga Komuna, ndërsa vetëm 7% mendojnë se kjo duhet të bëhet nga një subjekt privat. Një përqindje e lartë prej 11% kanë thënë se nuk kanë besim tek askush.



Grafiku 12: Besimi tek institucionet

Të anketuarit u pyetën për komente dhe propozime shtesë për përmirësimin e shërbimeve për të moshuarit. Më poshtë paraqiten përgjigjet e sistematizuara.

1. Aktivitete sociale dhe qendra:

- Krijimi i një klubi për pensionistët
- Hapja e qendrave ditore për të moshuar në disa lokacione të qytetit
- Hapja e një shtëpie shtetërore për të moshuar.

Organizimi i ekskursioneve brenda vendit

2. Shërbime shëndetësore, ndihmë dhe kujdes:

- Sigurimi i mundësive për trajtim në banja
- Rritja e orëve për përdoruesit e shërbimit të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi
- Sigurimi i kujdesit të veçantë për personat që janë të palëvizshëm dhe të varur nga kujdesi i anëtarëve të familjes“

3. Nevoja ekonomike:

- Rritja e pensioneve.

4. Përmirësime infrastrukturore:

- Përmirësimi i aksesit për personat me aftësi të kufizuara në institucione dhe objekte

Sigurimi i një salle të veçantë për aktivitete sportive dhe rekreative për të moshuarit ose përdorimi i sallave sportive të shkollave.

Përfundime dhe rekomandime

Me gjysmën e të anketuarve në moshën 65-74 vjeç dhe një pjesë të konsiderueshme mbi 75 vjeç, ekziston një tregues i qartë për plakjen e popullsisë në bashkësi. Kjo rrit nevojën për shërbime të përshtatura, kujdes mjekësor dhe mbështetje sociale për personat e moshuar.

Duke pasur parasysh që shumica e të anketuarve janë gra (55%), duhet të merret parasysh shqyrtimi i problemeve specifike shëndetësore, nevojave sociale dhe sistemit të mbështetjes për gratë. Gratë mund të jetojnë më gjatë se burrat, prandaj mund të zhvillohen programe për kujdes parandalues, të fokusuara në nevojat e tyre specifike.

Përqindja e lartë e personave të martuar (63.5%) sugjeron mbështetje brenda familjeve. Megjithatë, përqindja e konsiderueshme e të veve dhe vejushëve (33.7%) tregon për një grup të cënueshëm që ka nevojë për mbështetje shtesë emocionale dhe sociale.

Shumica e të anketuarve (83%) jetojnë në zona urbane, gjë që mund të nënkuptojë një qasje më të mirë ndaj shërbimeve shëndetësore dhe sociale. Megjithatë, ata që jetojnë në zona periferike ose rurale mund të kenë nevojë për programe të veçanta mbështetëse, veçanërisht për të siguruar qasje të shpejtë në shërbime mjekësore.

Të dhënat për gjendjen shëndetësore dhe kontaktet sociale të personave të moshuar duhet të merren seriozisht parasysh gjatë planifikimit të formave të mbrojtjes sociale që do të organizohen në komunë dhe të shërbimeve që do të ofrohen.

Shumica e të anketuarve e vlerësojnë gjendjen e tyre shëndetësore si të mirë ose të kënaqshme, por një numër i konsiderueshëm e vlerësojnë si të keqe dhe ekziston një nevojë e qartë për kontrolle mjekësore të rregullta dhe kujdes parandalues.

Shpeshmëria e lartë e vizitave mujore te mjeku (41%) sugjeron një varësi nga shërbimet mjekësore, gjë që mund të ngarkojë sistemin shëndetësor lokal.

Ndikimin më të madh në ndjenjën e sigurisë dhe cilësinë e jetesës te njerëzit e ka shtëpia dhe mjedisi ku jetojnë. Për personat e moshuar kjo është edhe më e rëndësishme, pasi ata kalojnë më shumë kohë në shtëpitë e tyre sesa grupmoshat e tjera.

Varësia nga bashkëshortët dhe fëmijët për kujdes (gjithsej 89 përgjigje) tregon një barrë të konsiderueshme për anëtarët e familjes. Duhet të sigurohet mbështetje për familjet që kujdesen për anëtarët e moshuar përmes trajnimeve dhe ndihmës financiare.

Të dhënat për shpeshmërinë e kontakteve me familjen dhe miqtë tregojnë se, edhe pse shumica kanë kontakte të rregullta, shqetësues është fakti se 13% kanë ndërveprime sociale të kufizuara, gjë që tregon rrezik nga izolimi social.

Shumica e të anketuarve (51) që janë pjesërisht të kënaqur me të ardhurat e tyre janë një tregues i pasigurisë financiare të personat e moshuar.

Edhe pse shumica e të anketuarve kanë kushte të mira ose të kënaqshme jetese, ekziston një grup i vogël me kushte të këqija, që thekson nevojën për përmirësimin e kushteve të banimit dhe aksesueshmërisë. Duhet të merren iniciativa për rinovimin e shtëpive me kushte të dobëta jetese dhe njëkohësisht të sigurohet më shumë akses në shërbimet publike për personat e moshuar me kufizime fizike.

Nevojat e ndryshme, nga ndërveprimet sociale deri te blerja e barnave dhe mirëmbajta e higjienës personale, tregojnë nevojën për një sistem gjithëpërfshirës mbështetjeje për personat e moshuar.

Preferenca për shërbime të organizuara nga institucionet publike sociale (39%) dhe organizatat qytetare (33%) thekson rëndësinë e forcimit të shërbimeve publike sociale dhe siguri të disponueshmërisë dhe besueshmërisë së tyre.

Bibliografija

Birren JE, Schroots JJF. History, concepts, and theory in the psychology of aging, 1996;

Ligji për Mbrojtjen Sociale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21)

Ligji për Sigurinë Sociale të Personave të Moshuar ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 104/19)

Ligji për Familjen ("Gazeta Zyrtare" nr. 84/2008)

Ligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor ("Gazeta Zyrtare" nr. 98/2012, nr. 166/12, nr. 15/13)

Strategjia Nacionale për Personat e Moshuar (2010-2020)

Shtojca:

Shtojca 1: Anketa për Regjistrimin e Nevojave të Personave të Moshuar në Komunën e Gostivarit

Shoqata për Ofrimin e Shërbimeve Sociale "SOCIO", Gostivar, po realizon regjistrimin e nevojave të personave të moshuar në Komunën e Gostivarit. Regjistrimi po realizohet në kuadër të projektit "Iniciativa Lokale për Përmirësimin e Shërbimeve Sociale për Personat e Moshuar". Projekti është një subgrant i fituar në kuadër të "Mbështetjes së BE për Qendrën e Resurseve Qytetare - faza 2", financuar nga Bashkimi Europian (BE).

1. Informacione të përgjithshme

1.1 Moshë:

a) 60 – 64 b) 65 -69 c) 70 – 74 d) 75 – 79 e) 80 – 84 f) 85 dhe më shumë

1.2 Gjinia:

a) Mashkullorë b) Femërore

1.3. Statusi martesor:

a) I martuar/e martuar b) I pa martuar/e pa martuar c) I divorcuar/e divorcuar
d) I ve/e ve e) bashkëjetë jashtë martesore

1.4 Përkatësia etnike:

a) Maqedon/e b) Shqiptar/e c) Turke/e d) Rom/e

e) Tjetër(Theksoni)_____

1.5 Vendbanimi:

a) Urban (në qytet)

b) Rural (lagje periferike, fshat) trego cili/cila_____

2. Gjendja shëndetësore

2.1 Si e vlerësoni gjendjen tuaj shëndetësore aktuale?

a) Shkëlqyeshme b) Mirë c) E kënaqshme d) E keqe e) Shumë e keqe

2.2. Sa shpesh keni nevojë për të vizituar mjekun?

a) çdo ditë b) një herë në javë c) një herë në muaj d) disa herë në vit

e) nuk kam nevojë

2.3 Kush kujdeset për ju kur jeni i/e sëmurë?

a) bashkëshorti/bashkëshortja b) fëmijët c) familjarë d) fqinjë/miq e) askush

3. Statusi familjarë

3.1.A jetoni vetëm apo me familje?

a) vetëm b) me partnerin martesorë c) me fëmijë d) me familjarë të tjerë

3.2. Sa shpesh keni kontakte/vizita nga familjarët dhe miqtë?

a) çdo ditë b) një deri në dy herë në javë c) disa herë në muaj

d) disa herë në vit

4. Kushtet materiale dhe kushtet e banimit

4.1. Cilat janë kushtet e banimit në vendbanimin tuaj?

a) shumë të mira b) të mira c) të kënaqshme d) të këqia

4.2. A keni nevojë nevojë për përmirësime ose përshtatje në vendbanimin tuaj?

Nëse po, cfarë? _____

4.3. A janë të ardhurat tua të mjaftueshme për të plotësuar nevojat tua personale?

- a) PO b) JO c) Pjesërisht

5. Mbështetje dhe shërbime

5.1. Çfarë lloj mbështetje ju nevojitet? (mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

- a) Mirëmbajtja e higjenës personale, mirëmbajtje e higjenës së rrobave – larja
b) blerje të barnave dhe ushqimeve, pagesë e faturave
c) transport
d) organizimi i kohës së lirë përmes aktiviteteve kulturore dhe argëtuese
e) shoqërim me bashkëmoshatar
f) Tjetër (shkruani):

5.2 Sipas mendimit tuaj, cilat shërbime do të ishin të dobishme për personat e moshuar në bashkësinë tuaj?

- a) Përdorimi i ndihmës dhe kujdesit në shtëpi
b) Përdorimi i shërbimeve në Qendrën Ditore për të moshuarit
c) Përdorimi i shërbimeve në Shtëpinë për të moshuarit

5.3 Cilat nga këto shërbime do të ishin të interesuar për t'i përdorur?

- a) Përdorimi i ndihmës dhe kujdesit në shtëpi
b) Përdorimi i shërbimeve në Qendrën Ditore për të moshuarit
c) Përdorimi i shërbimeve në Shtëpinë e të moshuarve

5. 4. Tek cili subjekt keni besim më të madh për t'i organizuar shërbimet e mbrojtjes sociale për të moshuarit?

- a) komuna
b) Institucioni publik për mbrojtje sociale
c) person juridik privat
d) organizata joqeveritare

e) tek askush

6. Komete dhe propozime shtesë

6.1. A keni ndonjë koment apo propozim për përmirësimin e shërbimeve për të moshuarit? ____

Shtojca 2 : Udhëzime për zhvillimin e intervistës me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave për regjistrimin e nevojave të personave të moshuar në komunën e Gostivarit

Informacione themelore për personin e intervistuar:

Emri dhe mbiemri:

Mosha:

Spektori/Institucioni/Organizata:

Pozita:

Të dhëna për kontakt (telefon/email):

1. Çfarë shërbimesh ofroni për personat e moshuar? (kujdes shëndetësor, mbështetje sociale, aktivitete ditore, ndihmë dhe kujdes në shtëpi, etj.)
2. Sa shpesh i ofroni këto shërbime? (ditore, javore, mujore)
3. A ka nevojë për zgjerimin e shërbimeve që ofroni? (Po/Jo)

Shpjegoni:

4. A ofroni programe për përfshirje sociale dhe aktivitete për personat e moshuar? (Po/Jo)

Shpjegoni:

5. A keni pajisje dhe hapësira të përshtatshme për kujdesin e personave të moshuar? (Po/Jo)

Shpjegoni:

6. A ka mjaftueshëm institucione dhe shërbime në komunën e Gostivarit që mund të plotësojnë nevojat individuale të personave të moshuar? (Po/Jo)

Shpjegoni:

7. Cilat shërbime do të ishin më të përshtatshme për personat e moshuar në komunën e Gostivarit? Shpjegoni:

